



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.669/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Lgjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me apelin e Shemsi Maksuti, anëtar i kryesisë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht si i bazuar apeli i Shemsi Maksuti, anëtar i kryesisë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj në Vendvotimet: 2101/X 06R, 2122/B 01R, 2126/B 01R, 2101/B 02R, 2101/B 03R, 2101/X 01R, 2101/X 03R, 2101/X 04R, 2101/X 06D, 2103/B 02R, 2106/B 01R, 2106/B 03R, 2107/B 02R, 2107/B 04R, 2112/B 01R, 2112/B 02R, 2113/B 01R, 2113/B 03D, 2114/B 01R, 2114/B 04D, 2116/B 03D, 2121/B 01R, 2121/B 02R, 2123/B 01R, 2125/B 01R, 2127/B 01R, 2129/B 01R, 2130/B 01R, 2130/B 02R, 2132/B 02R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet si i pabazuar apeli në raport me vendvotimet 2113B/01R, 2113B/02R, 2114B/03R, 2116B/02R, 2125B/02R, 2132B/01R.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 09.11.2017, nga Shemsi Maksuti, anëtar i kryesisë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, me të cilën pretendon se sipas raportëve nga ana e vëzhguesëve janë ndryshuar shiritat e rezultatëve të votave në FPR dhe mungojnë votat e familjarëve të ngusht, po ashtu nuk përputhen shifrat mes subjektit dhe votave në total të kandidatëve, ku dihet se votimi ka qenë “një votë për një kandidat”, këto mospërputhje janë në pesë vendvotime si në 2101/X 06R, 2113/B 01/R, 02/R, 2122/B 01/R, 2126/B 01/R, ndërsa ankesat e kandidatëve për mungesë të votave të sigurta familjare në këto vendvotime: 2101/B 02/R, 03/R, 2101/X 01/R, 03/R, 04/R, 06/D, 2103/B 02/R, 2106/B 01/R, 03/R, 2107/B 02/R, 04/R, 2112/B 01/R, 02/R, 2113/B, 01/R, 03/D, 2121/B 01/R, 02/R, 2123/B 01/R, 2125/B 01/R, 02/R, 2127/B 01/R, 2129/B 01/R, 2130/B 01/R, 02/R, 2132/B, 01/R, 02/R. Prandaj, ka kërkuar nga paneli që të hapen dhe të rinumrohen të gjitha kutit në të gjitha vendvotimet në mënyrë që të evidentohen shkeljet në vendvotimet e lartpërmendura në të cilat janë bërë parregullësi gjatë numërimit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet në apel janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga shkresat e lëndës andaj, mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Paneli me rastin e vendosjes si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi, paneli konstatoi se Vendvotimet: 2113B/01R, 2113B/02R, 2114B/03R, 2116B/02R, 2125B/02R, 2132B/01R, sepse të njëjtat janë numëruar në QNR, pasi që janë vlerësuar se kanë se kanë ekzistuar parregullësit në vendvotime, andaj paneli nuk gjeti arsye që të njëjtat Vendvotime të kthehen prap në rinumërim.

Andaj, PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj, me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e*

domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 669/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.